



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1073/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e votueses Halide Vrajolli, rruga “Minatori”, Komuna Prishtinës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.1073/2021 i datës 04.11.2021, i votueses Halide Vrajolli, rruga “Minatori”, Komuna Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në qendrën e votimit 1927E/08R.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Komunën e Prishtinës në Vendvotimin: 1927E/08R

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1073/2021, i paraqitur votuesja Halide Vrajolli, rruga Minatori-Komuna Prishtine, me të cilën pretendon se në Vendvotimin 1927E/08R nuk i figuron vota e saj e cila ishte e adresuar për kandidatin me numër 13 nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e saj.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se votueses Halide Vrajolli, rruga “Minatori”, Komuna Prishtine më të cilën kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin e lartcekur, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga apellesja në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekura është i bazuar .

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, për arsye se nga rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ-ja del se në vendvotimet 1927E/08R kandidati Xhavit Ahmeti i ka vetëm 0 votë ndërsa nga deklarata e votueses, i njëjti del se duhet të ketë se paku 1 votë, andaj PZAP ka konstatuar se ka mos përputhje të rezultateve përfundimtare dhe deklaratave të votuesve, andaj nga këto arsye dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.1073/2021 më datën 07.11.2021.

Kryesuese e Panelit
Milena Đeric



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.